



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.292, datë 31.07. 2023

PËR

“PEZULLIMIN NGA DETYRA TË PROKURORIT XHEVAHIR LITA”

Bazuar në nenet 148/d, pika 4, germa “a” dhe 149, pika 1, të Kushtetutës, 151 pika 1 germa “a” dhe pika 2 germa “a”, 155 dhe 156 pika 1, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 189 pika 1 germa “a”, 164 pika 8 dhe 190, pikat 1 dhe 2, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar si dhe në relacionin e Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pezullimin nga detyra të prokurorit Xhevahir Lita, aktualisht drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
2. Ky pezullim zgjat deri në rënien e shkakut për të cilin është vendosur.
3. Të njoftohet për këtë vendim prokurori Xhevahir Lita, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 31.07.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR

Alfred Balla

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

